VENDIM
Nr. 139, datë 7.7.2025

MBI HEQJEN E LICENCËS SË SHOQËRISË "ENERGIA GAS AND POWER ALBANIA" SHPK NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; neneve 5, germa "ç", dhe 9, germa "c", të rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; pikës 6.2, germa "ç", të "Kushteve të licencës për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 98, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.7.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1246/6 prot., datë 2.7.2025, të grupit të punës "Mbi heqjen e licencës së furnizimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë 'Energia Gas and Power Albania' sh.p.k."

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 90, datë 24.4.2025, vendosi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 322, seria F15/F20, për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Energia Gas and Power Albania" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 159, datë 28.12.2015, dhe rinovuar me vendimin nr. 209, datë 11.12.2020.

- Vendimi për fillimin e kësaj procedure u mor pasi shoqëria nuk kishte shlyer pagesën rregullatore ndaj ERE-s për vitin 2024, duke rezultuar debitore për këtë detyrim dhe nuk kishte depozituar asnjë dokument, apo argument që të justifikonte moszbatimin e tij.

- ERE ka njoftuar shoqërinë për këtë vendim me shkresën nr. 1338/1 prot., datë 30.4.2025, dhe i ka dërguar kopje të skanuar të shkresës në adresën e *e-mail*-it të regjistruar pranë ERE-s.

- Shkresa fizike është kthyer mbrapsht nga shërbimi postar, me shënimin "Larguar", ndërkohë që kontakti telefonik që disponon ERE i përket një personi që nuk është më pjesë e shoqërisë.

- Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 90, datë 24.4.2025, është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 89, datë 26.5.2025. Në këto kushte, afati 30-ditor për paraqitjen e kundërshtimeve, apo dokumentacionit përkatës, llogaritet të fillojë nga data e botimit të vendimit në Fletoren Zyrtare.

- Pavarësisht përpjekjeve të ERE-s për të njoftuar shoqërinë nëpërmjet kanaleve të disponueshme të komunikimit, është detyrim i të licencuarit të mbajë të përditësuara të dhënat e kontaktit pranë ERE-s. Në çdo rast, konsiderohet se shoqëria është njoftuar për vendimin përmes publikimit në Fletoren Zyrtare, siç parashikohet nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi.

- Në përfundim të afatit 30-ditor, më datë 26.6.2025, duke e përllogaritur këtë afat nga botimi në Fletoren Zyrtare, rezulton se shoqëria "Energia Gas and Power Albania" sh.p.k. nuk ka shlyer pagesën rregullatore, nuk ka paraqitur ndonjë shpjegim apo dokument për situatën e krijuar dhe nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim për të shmangur shkakun ligjor që çoi në fillimin e procedurës për heqjen e licencës.

- Në nenin 42, pika 1, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenin 5, germa "ç", të rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, si dhe pikën 6.2, germa "ç", të "Kushteve të licencës për veprimtarinë e furnizimit të

energjisë elektrike", parashikohet se: "ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE".

- Me heqjen e licencës, shoqëria nuk mban më statusin e të licencuarit nga ERE dhe nuk mund të ushtrojë më veprimtarinë për të cilën ishte pajisur me licencë.

- Pavarësisht vendimit për heqjen e licencës, shoqëria nuk çlirohet nga detyrimi për të shlyer detyrimet e prapambetura, përfshirë pagesën rregullatore të vitit 2025, miratuar me vendimin e Bordit të ERE, nr. 112, datë 23.5.2025, i ndryshuar, i cili ka hyrë në fuqi në kohën kur shoqëria ende gëzonte statusin e subjektit të licencuar.

- Mbledhja e këtyre detyrimeve do të bëhet me rrugë gjyqësore, sipas procedurave ligjore në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të heqë licencën nr. 322, seria F15/F20, për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Energia Gas and Power Albania" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 159, datë 28.12.2015, dhe rinovuar me vendimin nr. 209, datë 11.12.2020.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e sipërcituar bëhet e pavlefshme.

3. Grupi i punës të njoftojë shoqërinë "Energia Gas and Power Albania" sh.p.k., "OST" sh.a., OSSH sh.a. dhe "ALPEX" sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti